

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **616-24-4595-2-1-1**

Sa i përket tenderit për **Ri tender Loti 1, Sigurimi i objekteve të Komunës së Prishtinës dhe objekteve të institucioneve të arsimit dhe, Loti 2 Sigurimi fizik i objekteve të QKMF, QMF -se dhe QMU-se**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj	"Internat Security Association"SH.P.K.
NUI	601073042
Adresa	Mustafë Kruja nr.3
Vendi	PRISHTINË
Kodi postar	10000
Numri Telefonit	049778877
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj	Fitim Gashi
Adresa elektronike	info@securityisa.org
Data e parashtrimit të ankesës	14.06.2024



**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

Emri i avokatit
Adresa e plotë
Numri i Telefonit
Numri i faks-it
Adresa elektronike

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës” “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit”, apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Ankesa i përket grupeve:

Loti 1, Sigurimi i objekteve të Komunës së Prishtinës dhe objekteve të institucioneve të arsimit Loti 2 Sigurimi fizik i objekteve të QKMF, QMF -se dhe QMU-se

Njoftimi për kontratë 15.05.2024

Data e planifikuar e hapjes së tenderit 18.06.2024

Kërkesa për rishqyrtim e dt.04.06.2024

Vendim për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim 07.06.2024

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐

Jo ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☐

Jo ☒

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒

Jo ☐

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontestit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se.

Kërkesa për rishqyrtim dhe vendimi i AK

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmblylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie të Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1
Neni 6
Neni 7
Neni 17

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë e rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuara për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Kompania Private e Sigurimit **“INTERNATIONAL SECURITY ASSOCIATION SH.P.K,** ka terhequr dosjen e tenderit per ofrimin e sherbimeve te sigurimit fizik per komuna Prishtinë, mirepo gjate analizimit te saj ka hasur ne disa kërkesa te cilat jane diskriminuese per pjesmarrje te gjere te OE ne kete AP qe shkell neni 7 te Lpp-së, te cilat po I adresojme me ankesën drejtuar OSHP

a. Menaxheri i SHTHS dhe Shëndetit në punë.

Tek Kapaciteti teknik dhe professional AK ka kërkuar të caktohet një menaxher i cili duhet të ketë së paku 3 vite përvojë pune në shërbimet e sigurimit themelor të sigurimit, të dëshmojë që ka së paku 3 vite përvojë pune dhe të jetë I certifikuar njëkohësisht në dy dejtime menaxhim rrisht dhe I licencuar nga MPB si menaxher në detyrë si për shërbimet themelore dhe të specializuara.

Kjo kërkesë e AK është diskriminuese dhe kufizon tejmas pjesëmarrjen e OE në këtë AP, përshkak se mund të jenë dy persona të cilët mund të kryjnë secili profesionin e vetë.

b. Automjetet

Janë kërkuar që OE të ketë së paku 10 automjete për patrollim, përderisa I gjithë shërbimi do të kryhet brenda qytetit të Prishtinës atëherë është e palogjikshme të kërkojë një kërkesë e tillë dhe e pa nevojshme duke pas parasysh se ky shërbim mund të kryhet me shumë më pak vetura dhe poashtu kjo përbën edhe një kosto për kompaninë e cila duhet të kompenzohet disi edhe pse AK nuk jep ndonjë kërkesë ku OE mund të ofrojë cmim për këtë pikë të DT-së gjë e cila automatikisht përbën shkelje të nenit 7 të LPP-së.

Poashtu AK ka kërkuar që OE pjesëmarrës të posedojnë dhe të dëshmojnë me fatura se kanë mjaftueshëm pajisje për ekzekutimin e kontratës për punëtorët e sigurimit si shufra , pranga etj. Edhe kjo kërkesë është diskriminuese dhe përbën shkelje të nenit 7 të LPP-së. Asnjë nga OE pjesëmarrës nuk mund të ketë sasi të larta të këtyre pajisjeve në stok të cilat janë të kushtueshme, e poashtu nuk mund të sigurojnë pajisje të tilla për një tender për të cilin nuk është e sigurt se a mund të shpërblehen me kontratë e të siguroj një sasi aq të lartë të pajisjeve të cilat duhet të paguhet paraprakisht ende pa marrë pjesë në AP. Kjo kërkesë duhet të jetë si kusht vetëm për OE fitues në këtë AP.

c.Pastaj AK ka kërkuar që të bëhet një listë e stafit punonjës me të cilët OE do të jep dëshmi se do të mbulojë të gjitha pikat me punëtorë sigurimi ku duhet të bashkëngjiten si dëshmi edhe kontratat e punës, duke pas parasysh se kërkojë një numër I madh punëtorësh sigurimi kjo është kërkesë diskriminuese dhe poashtu kufizon tejmas pjesëmarrjen e OE në këtë AP, është kërkesë të cilën lehtësisht mund ta plotësojë vetëm OE I cili është duke ofruar në kohë reale shërbimet e sigurimit fizik në këtë fazë.

d. Pika më kritike e këtj AP është buxheti I caktuar nga AK I cili nuk mjafton të kryhen as për 50% këto shërbime të sigurimit fizik të kërkuara nga ju, ne ju kemi bërë kërkesë për sqarim sepse sipas një kalkulimi të thjeshtë del se buxheti I caktuar nga AK është I pamjaftueshëm dhe ky AP nuk mund të realizohet aspak me kërkesën e vendosur nga AK.

Më poshtë do të japim një shpjegim – analizë të thjeshtë tabelare ku ju do të vëreni lehtësisht se ky AP nuk ka buxhet të mjaftueshëm për ekzekutimin e këtyre shërbimeve.

Kërkesa për pagat e punëtorëve është , paga minimale e punonjësve të sigurimit të jetë në vlerë prej së paku 350 euro netto pagë që kur I shtohen të gjitha obligimet ligjore si kontributet nga punëmarrësi dhe pundhënësi si dhe tatami në burim I pagës arrijmë te shuma e saktë 404.69 euro cent.

Numri I punëtorëve të sigurimit bazuar në orët e punës është I barabartë me llot 1 31764 orë në muaj

apo 31764/176 orë mesatare mujore rekomandim I juaji për kalkulim të numrit të punëtorëve = 180.48 punëtorë kurse për llot 2 15052 orë për një muaj apo 15052/176 orë mesatare mujore për një punëtor sigurimi = 85.52 punëtorë apo gjithsej punëtorë për dy llotet 180.48+85.52 = 266 punëtorë sigurimi në total, nëse kalkulojmë vetëm pagat e tyre përgjatë kontratës prej 36 muaj atëherë :

Paga me te gjitha shpenzimet 350 euro netto plus taksat e tjera **404.63**

Numri I punetoreve te sigurimit **266**

Total paga per një muaj **107631.6**

Total paga per 36 muaj **3874737**

TVSH e obligueshme 18% 697452.6

Total vetem paga per 36 muaj **4572190**

Buxheti I caktuar nga AK 3,590,000.00 euro për 36 muaj, që dmth., është e pamundur të realizohet kjo kontratë duke pas parasysh se përpos pagave duhet të kalkulohen pushimet vjetore, festat, orët e natës, vikendet, pushimet mjekësore, kurse vetëm kostoja e pagave është 4,572,190.00 euro Poashtu si do të llogariten kostot e pajisjeve, veturave, pagat e njësiteve patrulluese etj.

Ju lutem që të gjitha vërejtjet tona ti merrni si të bazuara aproveni këtë Ankesë dhe lëndën ta anuloni dhe të detyroni AK që të krijojë specifikime të qarta dhe jo diskriminuese si dhe të merrni përbazë të gjitha kërkesat tona për këtë AP.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

Mundesia e pjesmarrjes ne AP dhe shperblii me kontrate.

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
- e) bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

***Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.